



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 281/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.05.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Nazeri 2000” shpk, në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr.REF-41282-01-22-2018 me objekt: “*Sherbimi i ruajtjes dhe siguris fizike me roje private per sh.a Ujesjelles Kanalizime Lushnje per vitin 2018- Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj*”, me fond limit 16, 100, 715.6 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 16.02.2018 nga autoriteti kontraktor, Ujësjiellës Kanalizime Lushnjë.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Bare” shpk në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Myrto Security” shpk në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

“Nazeri 2000” shpk
Rruga e Kavajës, Qendra Condor, Kati.II, Tiranë

“Bare” shpk
Lagjia “16 Prilli”, Rruga “Sotir Kola” pranë Stadiumit Fier

“Myrto Security” shpk
Lagjia “Kastriot”, Rruga “Brigada e 11 Sulmuese” godina e
Albtelecom Fier.

Autoriteti Kontraktor: Sh.a Ujësjiellës Kanalizime Lushnjë
Lagja “18-Tetori”

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjeve, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;

I.4. Kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesave pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 22.01.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr.REF-41282-01-22-2018 me objekt: “*Sherbimi i ruajtjes dhe siguris fizike me roje private per sh.a Ujesjelles Kanalizime Lushnje per vitin 2018-Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj*”, me fond limit 16, 100, 715.6 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 16.02.2018 nga autoriteti kontraktor, Ujësjiellës Kanalizime Lushnjë.

II.2. Në datën 16.02.2018 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 23.02.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku, referuar vlerave të ofertave ekonomike, të hedhura nga autoriteti kontraktor në SPE, rezulton si më poshtë vijon:

- Bare	14,606,953.00	I skualifikuar
- Polsaiz	14,606,953.00	I skualifikuar
- Goga	15,184,821.00	I kualifikuar
- Myrto Security	15,184,821.00	I skualifikuar
- Nazeri	15,184,821.00	I skualifikuar

II.4. Në datën 23.02.2018 operatori ekonomik “Nazeri 2000” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- *krahasuar ne objektet qe keni sherbyer sipas vertetimeve te leshuara nuk keni paraqitur vertetime per pervojen e meparshme nga te gjitha entet publike brenda afatit kohor te kerkuar zhvillon aktivitet ne spitalin e Ballshit. Autoriteti kontraktore ka pare te nevojshme te shikoj performancen dhe sjelljen e operatorit ekonomik ndaj kontraktoreve te enteve publike ndaj ka kerkuar vertetime nga entet publike jo me pare se tre muaj nga hapja e ofertes dhe per ata qe nuk kane patur kontrat me autoritete kontraktore publike jane kerkuar fatura tatimore te shitjes me subjektet private ku te shenohet data shuma dhe sherbimi i realizuar.*

II.5. Në datën 28.02.2018 operatori ekonomik “Nazeri 2000” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë:

- *Pretendimi i autoritetit kontraktor për skualifikimin e shoqërisë sonë nuk qëndron pasi: Nga ana jonë është paraqitur kontratë e ngjashme me Albcontrol ish Anta për kontratën datë 22.07.2015 dhe vërtetim performance nr.497/1 prot datë 27.07.2016 si dhe kemi paraqitur edhe fatura tatimore ku vlere prej 10,764,374 lekë tejkalon kërkesën e AK për vlerë 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet si dhe kontrata e paraqitur*

është brenda 3 viteve. Pra kriteri për të dëshmuar shërbimin e ngjashëm është plotësuar dhe përmbushur plotësisht dhe data e lëshimit të vërtetimit për një shërbim të ngjashëm të përfunduar nuk do të ndryshonte asnjë fakt dhe nuk do të përbënte asnjë ndryshim pasi funksioni i vërtetimit është të dëshmojë se shërbimi është realizuar me sukses pavarësisht datës kur lëshohet ky vërtetim. Për më tepër ne kemi paraqitur edhe një sërë faturash tatimore që vërtetojnë se shërbimi është realizuar dhe është përmbushur vlera e kontratës që është kërkuar në dst. Sa më sipër kërkojmë kualifikimin e ofertës sonë.

- Nga ana e AK duhet të bëheshin vlerësime bazuar në koston ditore dhe jo në total kjo në përputhje me rekomandimin datë 20.12.2017 nr.15166 dhe nr.1858 prot .
- Së treti duhet të shtohet arsye skualifikimi për shoqëritë Bare, Polsaiz pasi nuk kanë paraqitur analizë kostoje dhe ofertat e tyre nuk përmbushin detyrimet ligjore për pagë minimale, shtesa turni dhe sig shoqërore.
- Duhet të shtohet arsye skualifikimi për shoqëritë Bare, Polsaiz dhe të skualifikohet shoqëria Goga pasi nuk kanë përmbushur kërkesën e AK për certifikata të vlefshme brenda afatit 4 vjeçar sipas ligjit nr.75/2014 neni 5 pika 5 për numrin e kërkuar nga AK.
- Duhet të shtohet arsye skualifikimi për shoqëritë Bare, Polsaiz dhe të skualifikohet shoqëria Goga pasi nuk ka paraqitur vërtetim për taksat vendore për vitin 2017.
- Duhet të shtohet arsye skualifikimi për shoqëritë Bare, Polsaiz dhe të skualifikohet shoqëria Goga pasi nuk plotëson kërkesën për specifikime teknike shtojca 8 në dst ku AK ka kërkuar armë dhe këto shoqëri nuk kanë paraqitur dokumentacion (autorizim për blerje arme, kontratë blerje dhe faturë për armë) ku të vërtetojnë se kanë në pronësi të tyre armë për përmbushjen e kërkesës së dhënë në DST.
- Duhet të shtohet arsye skualifikimi për shoqëritë Bare, Polsaiz dhe të skualifikohet shoqëria Goga pasi nuk kanë paraqitur vërtetim për shlyerjen e detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike.
- Kërkojmë nga AK të bëhet kualifikimi i shoqërisë sonë dhe duhet të shtohen arsyet e skualifikimit për shoqërinë Bare, Polsaiz, dhe të skualifikohet shoqëria Goga pasi nuk kanë përmbushur detyrimet ligjore për pagën minimale, shtesa turni, sigurime dhe nuk kanë plotësuar kërkesat e kërkuara nga AK në DST.

II.6. Në datën 28.02.2019 me shkresën nr. 492/1 prot, operatori ekonomik ankimues “Nazeri 2000” sh.p.k., është vënë në dijeni nga autoriteti kontraktor në lidhje me refuzimin e ankesës.

II.7. Në datën 09.03.2018, pala ankimuese “Nazeri 2000” sh.p.k., ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Në datën 23.02.2018 operatori ekonomik ankimeus “Bare” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- nuk plotëson kriteret e vecanta të kualifikimit pasi ka paraqitur 23 certifikata punonjes shërbimi nga 26 që kerkohen si dhe kontratat individuale janë për 23 punonjes nga 26 që kerkohen.

II.9. Në datën 28.02.2018 operatori ekonomik “Bare” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor me pretendimet si më poshtë:

- *Kundërshtojmë arsyen e skualifikimit pasi ne kemi dorëzuarne PDF folderin me emërtim Bare Punonjës Shërbimi Kontrata Pune 1 ku janë 8 certifikata punonjës shërbimi dhe tetë kontrata pune. Punonjës Shërbimi, Kontrata Pune 2 ku janë 5 Certifikata Punonjës Shërbimi dhe 5 Kontrata Pune. Bare Punonjës Shërbimi Kontrata 3 ku janë 5 certifikata punonjës shërbimi dhe 5 kontrata pune. Punonjës Shërbimi dhe Kontrata 4 ku janë 5 certifikata punonjës shërbimi dhe 5 kontrata pune dhe Kontrata Pune Punonjës Shërbimi 5 ku janë 5 certifikata punonjës shërbimi dhe 5 kontratatpune. Po ti mbledhim bëjnë 28 certifikata dhe 28 kontrata pune. Sa më sipër kërkojmë kualifikimin e shoqërisë sonë.*
- *Kërkojmë skualifikimin e shoqërisë “Goga” shpk nuk përmbush xhiron mesatare vjetore të tre viteve të fundit në shumën e kërkuar.*
- *Nga verifikimi i dokumentave të kësaj shoqërie rezulton se ka të deklaruar në listpagesë e shoqërisë dhe në vërtetimin e drejtorisë së policisë 28 punonjës shërbimi. Por rezulton mospërputhje midis listpagesës dhe vërtetimit të policisë pasi disa nga punonjësit nuk figurojnë në vërtetimin e policisë. Ju keni kërkuar 26 punonjës shërbimi kur 6 prej tyre nuk figurojnë në vërtetimin e policisë së qarkut shoqëria Goga nuk përmbush kriterin për numrin e punonjësve të shërbimit të certifikuar. Gjithashtu në vërtetimin e policisë figurojnë emra të cilat nuk janë në listpagesa. Si i paguhen sigurimet shoqërore dhe shëndetësore këtyre punonjësve të cilët nuk figurojnë në listpagesa??. Me një veprim të thjeshtë aritmetik nëse 28 i zbresim 8 atherë ngelen 20 punonjës shërbimi që i paguhen sigurimet shoqërore. Për këtë arsye kërkojmë skualifikimin e shoqërisë Goga shpk.*

II.10. Në datën 05.03.2018 me shkresën nr.511/1 prot, operatori ekonomik “Bare” shpk, është vënë në dijeni nga autoriteti kontraktor në lidhje me refuzimin e ankesës.

II.11. Në datën 12.03.2018 pala ankimuese “Bare” shpk, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.12. Në datën 23.02.2018 operatori ekonomik “Myrto Security” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- *krahasuar ne objektet qe keni sherbyer sipas vertetimeve te leshuara nuk keni paraqitur vertetime per pervojen e meparshme nga te gjitha entet publike brenda afatit kohor te kerkuar si drejtoria e tatimeve Fier Prokuroria Fier dhe Lushnje. Autoriteti kontraktore ka pare te nevojshme te shikoj performancen dhe sjelljen e operatorit ekonomik ndaj kontraktoreve te enteve publike ndaj ka kerkuar vertetime nga entet publike jo me pare se tre muaj nga hapja e ofertes dhe per ata qe nuk kane patur kontrat me autoritete kontraktore publike jane kerkuar fatura tatimore te shitjes me subjektet private ku te shenohet data shuma dhe sherbimi i realizuar.*

II.13. Në datën 28.02.2018 operatori ekonomik “Myrto Security” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor me pretendimet si më poshtë:

- *Skualifikimi jonë është i gabuar pasi ne kemi paraqitur Kontratën nr.119/25 datë 27.05.2016 me vlerë 32.244.738 lekë dhe Shtesë Kontratën nr.119/32 prot datë 31.10.2016 me vlerë 4,073,238.37 lekë lidhur me OSHEE sha/Drejtoria Rajonale Fier, Vërtetimin nr.199/1 prot datë 12.01.2018 lëshuar nga OSHEE/ Drejtoria Rajonale Fier që konfirmon realizimin në mënyrë të suksesshme të kontratave të sipërcituara si dhe faturat tatimore të shitjes lëshuar për realizimin e këtij shërbimi. Pra rezulton se kemi përmbushur plotësisht kriterin e sipërcituar për rrjedhojë vendimi për refuzimin/skualifikimin e ofertës sonë është i gabuar.*
- *Së dyti operatorit ekonomik Nazeri 2000 shpk duhet ti shtohet arsyeja e skualifikimit pasi nuk ka paraqitur certifikatat e punonjësve të shërbimit brenda afatit 4 vjecar të vlefshmërisë duke mos plotësuar gjurmën e kapaciteti teknik të shtojcës 7.*

II.14. Në datën 06.03.2018 me shkresën nr. 512 prot datë 05.03.2017, operatori ekonomik ankimes “Myrto Security” sh.p.k., është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

II.15. Në datën 13.03.2018 pala ankimese “Myrto Security” shpk, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankesë dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.16. Nëpërmjet shkresës nr.492/4 prot, datë 16.03.2018 protokolluar me tonën me nr.452/2 prot datë 19.03.2018 dhe shkresës nr.512/4 datë 23.03.2018 protokolluar me tonën me nr.485/2 prot datë 26.03.2018, autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacionin e kërkuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit publik ankimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “krahësuar ne objektet që keni shërbyer sipas vërtetimeve të lëshuara nuk keni paraqitur vërtetime për përvojën e mëparshme nga të gjitha entet publike brenda afatit kohor të kërkuar zhvillon aktivitet në spitalin e Ballshit. Autoriteti kontraktore ka parë të nevojshme të shikoj performancën dhe sjelljen e operatorit ekonomik ndaj kontraktoreve të entete publike ndaj ka kërkuar vërtetime nga entet publike jo me parë se tre muaj nga hapja e ofertes dhe për ata që nuk kanë patur kontratë me autoritete kontraktore publike janë kërkuar fatura tatimore të shitjes me subjektet private ku të shenohet data shuma dhe shërbimi i realizuar”, si dhe lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Myrto Security” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se krahësuar ne objektet që

keni sherbyer sipas vertetimeve te leshuara nuk keni paraqitur vertetime per pervojen e meparshme nga te gjitha entet publike brenda afatit kohor te kerkuar si drejtoria e tatimeve Fier Prokuroria Fier dhe Lushnje. Autoriteti kontraktore ka pare te nevojshme te shikoj performancen dhe sjelljen e operatorit ekonomik ndaj kontraktoreve te enteve publike ndaj ka kerkuar vertetime nga entet publike jo me pare se tre muaj nga hapja e ofertes dhe per ata qe nuk kane patur kontrat me autoritete kontraktore publike jane kerkuar fatura tatimore te shitjes me subjektet private ku te shenohet data shuma dhe sherbimi i realizuar”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- a) Shërbime të mëparshme, të ngjashme, të kryera nga operatori ekonomik gjatë 3 tri viteve të fundit financiare, në një vlerë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet).

Këto shërbime të së njëjtës natyrë do të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë :

Operatori ekonomik për përvojën e mëparshme duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga te gjitha entet publike , ku kontraktori kryen sherbime. Vertetimi te jete i leshuar jo me pare se 3(tre) muaj nga data e hapjes se ofertave si dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet realizuara.

Ose

A.2 Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

III.1.2. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike konstatohet se operatorët ekonomikë ankimues “Nazeri 2000” shpk dhe “Myrto Security” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër kanë dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

“Nazeri” 2000 shpk

- Kontratë Nr.64/9 prot datë 22.07.2015 lidhur ndërmjet Albcontrol sha dhe shoqërisë Nazeri 2000 shpk me objekt ”Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me subjekte private”, me vlerë 10,764,374 lekë pa tvsh.
- Vërtetim nr.497/1 datë 27.07.2016 lëshuar nga Albcontrol sha me anë të së cilit vërtetohet se operatori ekonomik Nazeri 200 shpk ka përfunduar realizimin e kontratës Nr.64/9 prot datë 22.07.2015 me objekt ”Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me subjekte private”.
- Fatura Tatimore Shitje me përshkrim Shërbim Roje.

Myrto Security shpk

- Kontratë Shërbimi Nr.119/25 prot datë 27.05.2016 e lidhur ndërmjet OSHEE sha/Drejtoria Rajonale Fier dhe shoqërisë Myrto Security shpk me objekt Shërbim Privat i Sigurisë Fizike me vlerë 32,244,738 lekë pa tvsh.
- Shtesë Kontrate Nr.119/32 prot datë 31.10.2016 me vlerë 4,073,238.379 lekë pa tvsh.
- Vërtetim nr.199/1 datë 12.01.2018 për realizim me sukses të kontratës lëshuar nga OSHEE sha/ Drejtoria Rajonale Fier.
- Fatura Tatimore Shitje me përshkrim Shërbim Roje.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit....”.

III.1.4. Në nenin 28 “Kontratat e Shërbimeve” pika 3 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet se “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.

Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

III.1.5. Referuar sa më sipër, KPP gjykon se operatorët ekonomikë ankimues “Nazeri 2000” shpk dhe “Myrto Security” shpk kanë dorëzuar dokumentacion në përputhje me parashikimet ligjore si dhe me kriterin e kualifikimit të përcaktuar në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi. KPP gjykon se arsyeja e skualifikimit të operatorëve ekonomikë ankimues tejkalon parashikimet ligjore e konkretisht nenin 28 pika 3 “Kontratat e Shërbimit” të sipërcituar, pasi parashikimi në kriter që vërtetimi i lëshuar nga entet publike të jetë i kushtëzuar me afate kohore nuk gjen mbështetje ligjore. Kontratat e paraqitura nga operatorët ekonomikë ankimues së bashku me gjithë dokumentacionin shoqërues vërtetim realizimi si dhe fatura tatimore të shitjes dëshmojnë më së miri përvojën e ngjashme të operatorëve ekonomikë pjesmarrës e si rrjedhim skualifikimi i tyre është i pabazuar.

Sa më sipër pretendimi i operatorëve ekonomikë “Nazeri 2000” shpk dhe “Myrto Security” shpk qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Bare” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “*nuk ploteson kriteret e vecanta të kualifikimit pasi ka paraqitur 23 certifikata punonjes sherbimi nga 26 që kerkohen si dhe kontratat individuale janë për 23 punonjes nga 26 që kerkohen*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

1. *Certifikatat e “Punonjësit të Sherbimit” për jo më pak se 26 punonjes sherbimi të certifikuar, leshuar në baze të Ligjit nr.75/2014, datë 10.07.2014 “Për sherbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike”, të jenë me datën e leshimit dhe afati i vlefshmerisë së certifikatës.*
2. *Kontratat e punës individuale për 26 punonjes sherbimi për mbulimin e kohës sherbimit.*

III.2.2. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike konstatohet se operatori ekonomik ankimues “Bare” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- 28 Certifikata Punonjësish dhe 28 kontrata pune

III.2.3. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese*”.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit....*”.

III.2.4. Sa më sipër KPP konstaton se arsyeja e skualifikimit për operatorin ekonomik “Bare” shpk se ka dorëzuar 23 certifikata punonjësish shërbimi dhe 23 kontrata pune nga 26 të kërkuara nuk qëndron pasi operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar certifikatat e punonjësve dhe kontrata e punës në numër më të madh se ai i kërkuar në kriter.

Sa më sipër pretendimi i ankimuesit “Bare” shpk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” shpk “*Së treti duhet të shtohet arsye skualifikimi për shoqëritë Bare, Palsaiz pasi nuk kanë paraqitur analizë kostoje dhe ofertat e tyre nuk përmbushin detyrimet ligjore për pagë minimale, shtesa turni dhe sig shoqërore*”, Komisioni i prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që*

autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit....”.

III.3.2. Neni 56 i LPP përcakton shprehimisht se: “1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve ose shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve punë shpjegime për elementë të veçantë të ofertës, për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj”.

III.3.3. Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 66, pika 5, përcaktohet se: “- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur. - Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP”.

III.3.4. Referuar nenin 56 të LPP, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendimin përfundimtar për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP-së, në rast se një apo disa oferta vlerësohen anomalisht të ulëta.

Pra, autoriteti kontraktor dhe konkretisht Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të tij, ka detyrimin sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik të shqyrtojë dhe vlerësojë ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë në sistemin e prokurimeve elektronike, dhe kualifikon vetëm ofertat të cilat fillimisht plotësojnë të gjitha kërkesat ligjore, administrative, tekniko – profesionale, ekonomiko – financiare (kriteret kualifikuese) dhe që më pas nuk dalin me ofertë anomalisht të ulët pas përlllogaritjeve të kryera në përputhje me formulën përkatëse të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe në dokumentat standart të tenderit.

Bazuar në sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, komisioni i vlerësimit të ofertave të një autoriteti kontraktor, në rastin e procedurës së prokurimit për kryerjen e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, ka të njëjtin detyrim ligjor gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, pra verifikon ofertat që plotësojnë kriteret kualifikuese, e më pas, nuk rezultojnë të jenë anomalisht të ulëta.

III.3.5. Sqarojmë se legjislacioni për prokurimin publik jo më kot ka përcaktuar parashikimin e caktuar në nenin 56 të LPP, pikërisht për të mbrojtur autoritetin kontraktor në rastin e ofertave të papërgjegjshme, duke kryer përlllogaritjet përkatëse dhe evidentimin e ofertave anomalisht të ulëta.

Edhe në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët, ligjvënësi ka përcaktuar mënyrën e argumentimit dhe shpjegimit të kësaj oferte nga ana e operatorit ekonomik ankimes duke e dokumentuar, argumentuar me prova shkresore sqarimet për elementin apo elementët e veçantë të ofertës në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP.

Në rast se një ofertë ekonomike, autoritetit kontraktor do t'i rezultojë anomalisht e ulët, atëherë, legjislacioni për prokurimin publik ka përcaktuar mënyrën se si ky i fundit mund të mbrohet nga një ofertë e tillë dhe konkretisht duke i kërkuar operatorit ekonomik, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elementë të veçantë të ofertës për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

Referuar sa më sipër, një autoritet kontraktor ashtu siç vepron në çdo procedurë prokurimi, edhe në rastin e procedurës për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike, ka të drejtë që gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të zbatojë parashikimin ligjor në lidhje me ofertën anomalisht të ulët në rast se një ofertë rezulton e tillë.

III.3.6. Nga ana tjetër, në rastin e procedurave të prokurimit për shërbimin e ruajtjes dhe sigurisë fizike, nëse një autoritet kontraktor, për shkak edhe të vetë specifikës dhe veçantisë së këtij shërbimi, bazuar në të drejtën e tij për të përcaktuar kriteret në përputhje me natyrën dhe përmasat e objektit të prokurimit, ka kërkuar preventive apo analizë kosto, duke përfshirë në të gjithë elementët ligjorë që përbëjnë një kosto mujore duke detajuar zërat apo elementët e veçantë të kësaj kosto, mbi bazën e të cilave autoriteti kontraktor do të gjykojë ofertën e paraqitur, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se do të qëndrojë strikt vendimit të autoritetit kontraktor, mbi bazën e të cilit do të gjykojë më pas, si në rastin kur ka kryer vlerësimin e ofertave duke konkluduar mbi ofertën totale, ashtu edhe në rastin kur ka kërkuar një preventiv apo analizë kosto dhe ka bërë vlerësimin e ofertave duke shqyrtuar secilin zë apo element të veçantë të ofertës.

III.3.7. Komisioni i Prokurimit Publik, argumenton se ky qëndrim i tij bazohet në qëllimet e ligjit të prokurimit publik për rritjen e efikasitetit dhe efikasitetit në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore, mirëpërdorimin e fondeve publike dhe ulje të shpenzimeve procedurale; sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Në rast se autoritetet kontraktore do të veprojnë në kundërshtim me sa më sipër, atëherë Komisioni i Prokurimit Publik do t'i rishikojë administrativisht duke i gjykuar ato si të gabuara.

Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, përfituesi i drejtëpërdrejtë i shërbimit të kërkuar (në këtë rast shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike), është vetë autoriteti kontraktor dhe si i tillë ai ka një pozitë të veçantë dhe është përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin e zbatimit të kontratës sipas legjislacionit në fuqi, kjo bazuar në nenin 62 të LPP “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës”, ku përcaktohet se: *“1. Autoriteti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit organin ose organet, nga të cilët kandidati ose ofertuesi mund të marrë informacionin e duhur për detyrimet fiskale, për mbrojtjen e mjedisit, për mbrojtjen e punonjësve dhe kushtet e punës, që janë në fuqi në Shqipëri ose në rajonin apo nësinë vendore ku do të zbatohet kontrata.*

2. Ofertuesit ose kandidatit mund t'i kërkohet të dëshmojë se gjatë hartimit të ofertës i ka marrë parasysh detyrimet, që shoqërojnë zbatimin e kontratës, siç është vendosur nga organet kompetente, në përputhje me pikën 1 të këtij neni.

3. Detyrimet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, si dhe kushtet e parashikuara në nenin 46 të këtij ligji janë të vlefshme gjatë të gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. Çdo shmangie nga këto kushte apo detyrime çon në prishjen e kontratës”.

Pra është autoriteti kontraktor si organi me interes dhe përgjegjësi për realizimin me sukses të kontratës, është pikërisht ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës për t'u siguruar nëse cilësia e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë.

Nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, ligji i prokurimit publik nuk ka për qëllim që nëpërmjet tij dhe përcaktimeve të tij të kontrollohen një sërë ligjesh të tjera, ashtu siç edhe në rastin e shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike që një element kryesor është paga minimale, e cila në rastet kur autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar një preventiv apo analizë kosto apo kur oferta nuk konstatohet të rezultojë anomalisht e ulët, nuk ka pse të jetë objekt kontrolli edhe nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, pasi ka organe të tjera që merren me kontrollin dhe monitorimin e respektimit të legjislacionit në lidhje me pagën minimale të punonjësve në shkallë vendi.

Në rast se ofertat e kualifikuara nuk rezultojnë anomalisht të ulëta, pas përlllogaritjeve përkatëse, apo në rast se rezultojnë të tilla dhe nga autoriteti kontraktor nuk evidentohen shkelje të atij karakteri që të konsiderohen haptazi në kundërshtim me ligjin, të tilla që të ndikojnë në mirëpërdorimin e fondeve publike, si qëllim parësor të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, por bindet me provat dhe argumentat e paraqitura nga operatori ekonomik, atëherë, autoriteti kontraktor duhet të lidhë kontratë me ofertuesin i cili ka paraqitur ofertën më të mirë në përputhje me nenin 55 të këtij ligji.

III.3.8. Në shtojcën 1 “Formulari i Ofertës” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohen të dhënat e shërbimit si më poshtë:

1	2	3		4	5
Nr	Përshkrimi i Shërbimeve	Njesia	Sasia	Çmimi Njësi /ditë	Afati i perlllogaritur në ditë
1.	Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje privat të objekteve të SHA Ujesjelles Kanalizime 5 vendroje me 24 ore sherbim me 4.98 punonjes .	ditë	1		
2.	Nje vendroje Turni I (7-15) me 1.2 punonjes sherbimi	ditë	1		
	Çmimi Neto				
	TVSH (%)				
	Çmimi Total				

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

Sqarime:

1. Në çmim të jenë të përfshira të gjitha shpenzimet për detyrimet fiskale që parashikon kuadri ligjor në lidhje me pagat, sigurimet shoqerore dhe shëndetësore për shërbimin e ruajtjes në një vend roje me tre turne.

Bashkëlidhur formularit të çmimit të ofertës të paraqitet preventivi **për një roje**

1.Depo e Ujit Nr 1	4.98 punonjes sherbimi
2.Depo e Ujit Nr 2	4.98 punonjes sherbimi
3.Pika e furnizimit me uje Konjat	4.98 punonjes sherbimi
4.Pika e furnizimit me uje Gajde	4.98 punonjes sherbimi
5.Zyrat e Drejtorise UK	4.98 punonjes sherbimi
6.Arka Nr 1	1 .2 punonjes sherbimi

2. , sipas tabelës së mëposhtme. Operatorët Ekonomikë duhet të paraqesin ofertat ekonomike bazuar në analizen e kostos ditore të kryerjes së shërbimit.

Analize e kostos

Nr.	Emërtimi	Vlera (Lek) 1 roje /ditë	Vlera (Lek) 1 vendroje me 3 turne /ditë .
1	Shpenzime për pagë bazë		
2	Shtesë mbi pagë për turnin II		
3	Shtesë mbi pagë për turnin III		
4	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%		
	Vlera totale pa tvsh për 1 roje në ditë		
	Vlera totale me tvsh për 1 roje në ditë		

Analize e kostos

Nr.	Emërtimi	Vlera (Lek) 1 roje /ditë	Vlera (Lek) 1 vendroje me 1 turn i I-re /ditë
1	Shpenzime për pagë bazë		
2	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore 16.7%		
	Vlera totale pa tvsh për 1 roje në ditë		
	Vlera totale me tvsh për 1 roje në ditë		

Operatorët janë të detyruar të paraqesin preventivin sipas zërave të mësipërm, duke pasqyruar të gjitha kostot për të cilat kanë detyrime ligjore në zbatim të VKM Nr. 399, datë 3.5.2017, "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Ligji 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike".

- Numri i punonjësve të nevojshëm të shërbimit për pese vendroje me 3 turne nga e hena te premtë dhe 24 ore ne ditet e pushimit, te llogaritet **4.98 punonjes sherbimi, ndersa per nje vendroje prej ores 07-15 te llogaritet 1.2 punonjes sherbimi**
- Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e kostos në plotësimin e preventivit (si psh: paga bazë, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore e shëndetësore), rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.
- Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Lek (e kërkuar në dokumentat e tenderit)

III.3.9. Në shtojcën 8 "Specifikimet Teknike" të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Të dhëna për shërbimin e kërkuar

Objektet që do të ruhen ;

1.Depo e Ujit Nr 1	4.98 punonjes sherbimi
2.Depo e Ujit Nr 2	4.98 punonjes sherbimi
3.Pika e furnizimit me uje Konjat	4.98 punonjes sherbimi
4.Pika e furnizimit me uje Gajde	4.98 punonjes sherbimi
5.Zyrat e Drejtorise UK	4.98 punonjes sherbimi
6.Arka Nr 1	1.2 punonjes sherbimi

Numri i Punonjesve te sherbimit 26.1

Pese vendroje do te ruhen me tre turne ndersa nje vendroje do te ruhet me nje turn 07-15 sipas kushteve te kontrates.

III.3.10. Në shtojcën 10 "Shërbimet dhe Grafiku i Ekzekutimit" të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Shërbimi që kërkohet: Objekti: "Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje privat të objekteve SH.A Lushnje" – Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 12 muaj.

Afatet e ekzekutimit: 12 muaj (i parashikuar)

Vendndodhja e sherbimit: Objektet qe do te ruhen ;

1.Depo e Ujit Nr 1	4.98 punonjes sherbimi
2.Depo e Ujit Nr 2	4.98 punonjes sherbimi
3.Pika e furnizimit me uje Konjat	4.98 punonjes sherbimi
4.Pika e furnizimit me uje Gajde	4.98 punonjes sherbimi
5.Zyrat e Drejtorise UK	4.98 punonjes sherbimi
6.Arka Nr 1	1 .2 punonjes sherbimi

<i>Numri i Vendrojeve</i>	<i>Numri i turneve</i>	<i>Numri i rojeve te nevojshme</i>	<i>Afati i levrimit</i>
5	3 turne	4.98 punonjes	12 muaj
1	1 turn 7-15	1.2 punonjes	Kontratat do te jepen nga momenti i lidhjes se Marrveshjes Kuader me OE shpallur fitues nga kjo procedure prokurimi, sipas përcaktimit të AK me afat perfundimtar 12 muaj.

III.3.11. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, ka kërkuar shprehimisht se të gjithë ofertuesit, do të paraqesin ofertat ekonomike bazuar në analizen e kostos ditore të kryerjes së shërbimit. Në ofertën e tyre ekonomike, duhet të parashikojnë të gjitha detyrimet ligjore për kryerjen e këtij shërbimi; pra më konkretisht ofertuesit duhet të përllogarisin pagën bazë minimale ligjore, shtesat mbi pagë për turnin e dytë dhe të tretë si dhe kontributet shoqërore dhe shëndetësore në masën 16,7%. Komisioni gjykon se një ofertë vlerësohet e vlefshme, vetëm në rastin ku ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik, pasi mori në shqyrtim ofertën ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik “Bare” shpk konstaton se oferta për 1 vendroje (4,98 roje) me tre turne në ditë, si dhe për 1 vendroje (1,2 roje) me turn të parë (të cilat përbëjnë një element në ofertën totale referuar kohëzgjatjes së shërbimit), rezulton të jetë nën minimumin e lejuar ligjor të këtij shërbimi.

Komisioni sqaron se është detyrë e operatorëve ekonomikë që të garantojnë që oferta e paraqitur të përfshijë të gjithë elementët e kërkuar nga autoriteti kontraktor me qëllim garantimin e një kontrate të sukseshme. Në rastin në fjalë, operatori ekonomik “Bare” shpk ka dështuar të përmbushë detyrimin bazë për një ofertues, që është ofertimi në përputhje me përcaktimet në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi dhe në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Nazeri 2000” shpk qëndron.

Ndërsa sa i takon pretendimit të operatorit ekonomik “Nazeri 2000” shpk mbi shtimin e arsyeve të skualifikimit për operatorin ekonomik “Polsaiz” shpk, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, fati i kësaj shoqërie është përcaktuar tashmë prej vendimit të KVO-së të datës 23.02.2018, ku kjo shoqëri rezulton e skualifikuar nga kjo procedurë prokurimi, e për rrjedhojë pa asnjë ndikim në interesat e ankimuesit. Për më tepër, nga shqyrtimi administrativ i ankesave, nuk rezulton që ky operator ekonomik të jetë ankimuar pranë KPP-së.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Nazeri 2000” shpk mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Goga” shpk me argumentin se “*nuk kanë përmbushur kërkesën e AK për certifikata të vlefshme brenda afatit 4 vjeçar sipas ligjit nr.75/2014 neni 5 pika 5 për numrin e kërkuar nga AK*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se ,

III.4.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- *Çertifikatat e “Punonjësit të Sherbimit” për jo më pak se 26 punonjës shërbimi të certifikuar, leshuar në bazë të Ligjit nr.75/2014, datë 10.07.2014 “Për shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike”, të jete me datën e leshimit dhe afati i vlefshmeris se certifikates.*

III.4.2. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike konstatohet se operatori ekonomik ankimues “Goga” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Certifikatë Nr.1350 datë 30.09.2014
- Certifikatë Nr.0433 datë 01.12.2011
- Certifikatë Nr.0143 datë 28.06.2010
- Certifikatë Nr.0129 datë 31.05.2010
- Certifikatë Nr.1002 datë 28.01.2014
- Certifikatë Nr.0071 datë 30.12.2009
- Certifikatë Nr.0566 datë 03.07.2012
- Certifikatë Nr.0589 datë 05.10.2012
- Certifikatë Nr. 0161 datë 28.07.2010
- Certifikatë Nr.1476 datë 26.12.2014
- Certifikatë Nr.0464 datë 27.12.2011
- Certifikatë nr.0503 datë 01.03.2012
- Certifikatë Nr.1640 datë 27.09.2016
- Certifikatë Nr.0141 datë 28.06.2010
- Certifikatë Nr.0128 datë 31.05.2010
- Certifikatë Nr.0656 datë 02.11.2012
- Certifikatë Nr.0528 datë 30.04.2012
- Certifikatë Nr.0566 datë 03.07.2012
- Certifikatë Nr.1372 datë 16.10.2014

- Certifikatë Nr.0395 datë 02.08.2011
- Certifikatë Nr.0634 datë 02.11.2012
- Certifikatë Nr.0684 datë 10.12.2012
- Certifikatë Nr.0657 datë 02.11.2012
- Certifikatë Nr.0500 datë 01.03.2012
- Certifikatë Nr.0594 datë 05.10.2012
- Certifikatë Nr.0296 datë 25.05.2011
- Certifikatë Nr.0520 datë 23.03.2012
- Certifikatë Nr.0530 datë 30.04.2012
- shkresë nr. 465 Prot., datë 30.01.2018, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier, ku vërtetohet performanca e veprimtarisë së SHPSF “Goga”

III.4.3. Referuar korendosjen të mbajtur nga KPP me disa nga drejtoritë vendore të policive (Drejtoria Vendore të Policisë Fier dhe Tiranë) për disa çështje të ngjashme këto të fundit sqarojnë se: *“Cilësimi i (vlefshëm) në vërtetimet e performancave për punonjës të certifikuar të cilëve sipas ligjit aktual i ka përfunduar afati 4 vjeçar, është bërë për shkak të vakumit ligjor të krijuar nga anulimi i udhëzimit 308, datë 22.05.2017 “Për funksionin e shërbimit privat të sigurisë fizike dhe Qendrës së Trajnimit Privat të punonjësve të SHPSF-ve” si dhe akteve ligjore e nënligjore për zbatimin e ligjit 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”. Mungesa e bazës ligjore pezulloi përkohësisht procesin e certifikimit të aplikantëve për shpsf-t, dhe qëllimi i cilësimit i “vlefshëm” ishte shmangia nga penaliteti i punonjësve të cilët sipas ligjit aktual paise me certifikatat me afat 4 –vjeçar. Bazuar në nenin 5 të ligjit 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, dhe Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr. 130, datë 05.03.2018 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike”, afati i vlefshmërisë së certifikatave të punonjësve të shërbimit, shpsf, është 4 vjeçar nga momenti i certifikimit të tyre”.*

III.4.4. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 5, parashikohet si më poshtë: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

- a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose
- c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.4.5. Neni 5 i Ligjit Nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” parashikon shprehimisht se:

1. Certifikimi i titullarit dhe i drejtuesit teknik të SHPSF-së është kompetencë e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
2. Certifikimi i punonjësit të shërbimit është kompetencë e drejtorit të policisë së qarkut.

3. Vendimet e certifikimit, sipas përcaktimeve në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, lëshohen duke u bazuar respektivisht në mendimin paraprak të KSHKCL-së dhe KSHKC-së.

4. Pajisja me certifikatë e titullarit të subjektit dhe drejtuesit teknik bëhet brenda 45 ditëve, ndërsa për punonjësën e shërbimit bëhet brenda 30 ditëve nga dita e plotësimit të formularit të kërkesës për aplikim.

5. Certifikata është e vlefshme për 4 vjet me të drejtë ripërtëritjeje, për titullarin e subjektit, për drejtuesin teknik dhe punonjësën e shërbimit.

III.4.6. Referuar legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të nenit 46 pika 1 gërma "b", të Ligjit Nr.9643 dt.20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, i cili parashikon se: "[...] aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës [...]".

III.4.7. Në rekomandimin e përbashkët ndërmjet Komisionit të Prokurimit Publik dhe Agjencisë së Prokurimit Publik "Mbi mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit për shërbimin privat të ruajtjes fizike", i datës 20.12.2017, publikuar në faqen zyrtare të KPP, në pikën 2, paragrafi 7, është parashikuar shprehimisht: "Në lidhje me hartimin e kriterit për paraqitjen e certifikatave të punonjësve të shërbimit, në kushtet kur, procesi i ricertifikimit të punonjësve të shërbimit nuk ka përfunduar ende dhe është në proces për një afat të pacaktuar, kjo sipas informacionit të dhënë nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, autoritetet kontraktore rekomandohen si më poshtë vijon: Në rastet kur, në dokumentat e tenderit do të kërkohet paraqitja e certifikatave të punonjësve të shërbimit, së bashku me këtë kriter rekomandojmë që, të kërkohet edhe paraqitja e një vërtetimi të lëshuar nga Drejtoria e Policisë Vendore, i cili duhet të përmbajë të dhëna për listën emërore të punonjësve të shërbimit të certifikuar, dhe vlefshmërinë e këtyre certifikatave, datën e certifikimit (datën e lëshimit), si dhe afatin e vlefshmërisë së kësaj certifikate."

III.4.8. Sa më sipër, Komisioni vlerëson se operatori ekonomik "Goga nuk ka mundur të paraqesë numrin e kërkuar të certifikatave të vlefshme për të gjithë punonjësit e shërbimit të kërkuar në kriterin e vecantë të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor pasi vetëm 4 nga 26 të kërkuara janë të vlefshme brenda afatit 4 vjeçar të përcaktuar në ligj ndërsa certifikatat e tjera të punonjësve janë jashtë afatit të vlefshmërisë.

Komisioni vëren se në asnjë dispozitë ligjore apo akt nënligjor nuk parashikohet se certifikatat për punonjësit e shërbimit janë me afat të pacaktuar, përkundrazi për afatin e vlefshmërisë së tyre, pika 5 e nenit 5 të ligjit Nr. 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike", parashikon se certifikatat lëshohen për një afat 4-vjeçar me të drejtë ripërtëritje. Edhe vetë Drejtoritë Vendore të Policisë, me tagrat e organit kompetent dhe përgjegjës për certifikimin e punonjësve të shërbimit të shoqërive shpsf, sqaron në kthimin e përgjigjes drejtuar Komisionit të Prokurimit

Publik, se afati i vlefshmërisë së certifikatave të punonjësve të shërbimit shpsf, është 4 vjeçar, nga momenti i certifikimit.

APP dhe KPP rekomandojnë se, në rastet kur në dokumentat e tenderit do të kërkohej paraqitja e certifikatave të punonjësve të shërbimit, së bashku me këtë kriter, të kërkohej edhe paraqitja e një vërtetimi të lëshuar nga Drejtoria e Policisë Vendore, i cili duhet të përmbajë të dhëna për listën emërore të punonjësve të shërbimit të certifikuar, dhe vlefshmërinë e këtyre certifikatave, datën e certifikimit (datën e lëshimit), si dhe afatin e vlefshmërisë së kësaj certifikate.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në shkresën nr. 465 Prot., datë 30.01.2018, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier, ku vërtetohet performanca e veprimtarisë së SHPSF “Goga” sh.p.k., Drejtoria Vendore e Policisë Fier nuk ka përcaktuar afat vlefshmërie të certifikatave të punonjësve të shërbimit të listuar në këtë shkresë (vërtetim), por thjesht ka cituar në listën emërore të punonjësve “ e vlefshme” si dhe ka pasqyruar vetëm datën e marrjes së këtyre certifikatave.

Nga ana tjetër, Drejtoritë Vendore të Policive, siç cituam edhe më sipër, sqarojnë më së miri në lidhje me afatin e vlefshmërisë së këtyre certifikatave në korrespondencën zyrtare me Komisionin e Prokurimit Publik.

Komisioni gjykon se me anë të vërtetimit të kërkuar, autoritetet kontraktore kërkojnë të vërtetojnë nëse punonjësi i shërbimit është pjesë e stafit të operatorit ekonomik pjesëmarrës, si dhe datën e përfundimit të vlefshmërisë së certifikatës, ndërsa afati i vlefshmërisë së tyre përcaktohet në mënyrë eksplicite në ligj, fakt ky i theksuar edhe nga vetë Drejtoritë Vendore të Policive përkatëse, në kthimin e përgjigjes drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Nazeri 2000” shpk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Myrto Security” shpk “operatorit ekonomik “Nazeri 2000” shpk duhet ti shtohet arsyeja e skualifikimit pasi nuk ka paraqitur certifikatat e punonjësve të shërbimit brenda afatit 4 vjeçar të vlefshmërisë duke mos plotësuar gërmën i kapaciteti teknik të shtojcës 7”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.5.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- *Certifikatat e “Punonjësit të Shërbimit” për jo më pak se 26 punonjës shërbimi të certifikuar, lëshuar në bazë të Ligjit nr.75/2014, datë 10.07.2014 “Për shërbimin e ruajtjes dhe të sigurisë fizike”, te jete me datën e lëshimit dhe afatin e vlefshmërisë së certifikatës.*

III.5.2. Nga verifikimet në Sistemin e Prokurimeve Elektronike konstatohet se operatori ekonomik ankimues “Nazeri 2000” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Certifikatë Nr.1431 datë 27.11.2014
- Certifikatë Nr.1294 datë 29.08.2014
- Certifikatë Nr.1190 datë 29.05.2014
- Certifikatë Nr.1130 datë 21.04.2014

- Certifikatë Nr.1053 datë 10.03.2014
- Certifikatë Nr.1040 datë 20.02.2014
- Certifikatë Nr.0935 datë 27.11.2013
- Certifikatë Nr.0860 datë 26.09.2013
- Certifikatë Nr.1701 datë 06.09.2017
- Certifikatë Nr.1693 datë 16.06.2017
- Certifikatë Nr.0629 datë 02.11.2012
- Certifikatë Nr.0250 datë 26.01.2011
- Certifikatë Nr.1273 datë 25.07.2014
- Certifikatë Nr.1526 datë 04.03.2015
- Certifikatë Nr.1132 datë 21.04.2014
- Certifikatë Nr.0667 datë 10.12.2012
- Certifikatë Nr.0027 datë 29.03.2010
- Certifikatë Nr.0571 datë 03.07.2012
- Certifikatë Nr.0705 datë 10.12.2012
- Certifikatë Nr.094 datë _____.____ 2010
- Certifikatë Nr.0544 datë 30.04.2012
- Certifikatë Nr.1637 datë 22.08.2016
- Certifikatë Nr.0804 datë 27.05.2013
- Certifikatë Nr.1088 datë 10.03.2014
- Certifikatë Nr.1274 datë 25.07.2014
- Certifikatë Nr.1385 datë 16.10.2014
- Certifikatë Nr.0995 datë 28.01.2014
- Certifikatë Nr.0147 datë 28.07.2010
- Certifikatë Nr.0366 datë 29.06.2011
- Certifikatë Nr.1260 datë 25.07.2014
- shkresë nr. 440 Prot., datë 17.01.2018, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier, ku vërtetohet performanca e veprimtarisë së SHPSF “Nazeri 2000” sh.p.k.,

III.5.3. Referuar korenspondences së mbajtuar nga KPP me disa nga drejtoritë vendore të policive (Dejtorisë Vendore të Policisë Fier dhe Tiranë) për disa çështje të ngjashme këto të fundit sqarojnë se: *“Cilësimi i (vlefshëm) në vërtetimet e performancave për punonjës të certifikuar të cilëve sipas ligjit aktual i ka përfunduar afati 4 vjeçar, është bërë për shkak të vakumit ligjor të krijuar nga anulimi i udhëzimit 308, datë 22.05.2017 “Për funksionin e shërbimit privat të sigurisë fizike dhe Qendrës së Trajnimit Privat të punonjësve të SHPSF-ve” si dhe akteve ligjore e nënligjore për zbatimin e ligjit 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”. Mungesa e bazës ligjore pezulloi përkohësisht procesin e certifikimit të aplikantëve për shpsf-t, dhe qëllimi i cilësimit i “vlefshëm” ishte shmangia nga penalteti i punonjësve të cilët sipas ligjit aktual paisen me certifikatat me afat 4 –vjeçar.*

Bazuar në nenin 5 të ligjit 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, dhe Udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr. 130, datë 05.03.2018 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike”, afati i vlefshmërisë së certifikatave të punonjësve të shërbimit, shpsf, është 4 vjeçar nga momenti i certifikimit të tyre”.

III.5.4. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 5, parashikohet si më poshtë: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

- a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose
- b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose
- c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose
- ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.5.5. Neni 5 i Ligjit Nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” parashikon shprehimisht se:

1. Certifikimi i titullarit dhe i drejtuesit teknik të SHPSF-së është kompetencë e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.
2. Certifikimi i punonjësit të shërbimit është kompetencë e drejtorit të policisë së qarkut.
3. Vendimet e certifikimit, sipas përcaktimeve në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, lëshohen duke u bazuar respektivisht në mendimin paraprak të KSHKCL-së dhe KSHKC-së.
4. Pajisja me certifikatë e titullarit të subjektit dhe drejtuesit teknik bëhet brenda 45 ditëve, ndërsa për punonjësin e shërbimit bëhet brenda 30 ditëve nga dita e plotësimit të formularit të kërkesës për aplikim.
5. Certifikata është e vlefshme për 4 vjet me të drejtë ripërtëritjeje, për titullarin e subjektit, për drejtuesin teknik dhe punonjësin e shërbimit.

III.5.6. Referuar legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të nenit 46 pika 1 gërma “b”, të Ligjit Nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se: “[...] aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës [...]”.

III.5.7. Në rekomandimin e përbashkët ndërmjet Komisionit të Prokurimit Publik dhe Agjencisë së Prokurimit Publik “Mbi mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit për shërbimin privat të ruajtjes fizike”, i datës 20.12.2017, publikuar në faqen zyrtare të KPP, në pikën 2, paragrafi 7, është parashikuar shprehimisht: “Në lidhje me hartimin e kriterit për paraqitjen e certifikatave të punonjësve të shërbimit, në kushtet kur, procesi i ricertifikimit të punonjësve të shërbimit nuk ka

përfunduar ende dhe është në proces për një afat të pacaktuar, kjo sipas informacionit të dhënë nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, autoritetet kontraktore rekomandohen si më poshtë vijon: Në rastet kur, në dokumentat e tenderit do të kërkohet paraqitja e certifikatave të punonjësve të të shërbimit, së bashku me këtë kriter rekomandojmë që, të kërkohet edhe paraqitja e një vërtetimi të lëshuar nga Drejtoria e Policisë Vendore, i cili duhet të përmbajë të dhëna për listën emërore të punonjësve të shërbimit të certifikuar, dhe vlefshmërinë e këtyre certifikatave, datën e certifikimit (datën e lëshimit), si dhe afatin e vlefshmërisë së kësaj certifikate.”

III.5.9. Sa më sipër, Komisioni vlerëson se operatori ekonomik “Nazeri 2000” nuk ka mundur të paraqesë numrin e kërkuar të certifikatave të vlefshme për të gjithë punonjësit e shërbimit të kërkuar në kriterin e vecantë të kualifikimit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor pasi vetëm 16 nga 26 të kërkuara janë të vlefshme brenda afatit 4 vjeçar të përcaktuar në ligj ndërsa certifikatat e tjera të punonjësve janë jashtë afatit të vlefshmërisë.

Komisioni vëren se në asnjë dispozitë ligjore apo akt nënligjor nuk parashikohet se certifikatat për punonjësit e shërbimit janë me afat të pacaktuar, përkundrazi për afatin e vlefshmërisë së tyre, pika 5 e nenit 5 të ligjit Nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, parashikon se certifikatat lëshohen për një afat 4-vjeçar me të drejtë ripërtëritje. Edhe vetë Drejtoritë Vendore të Policisë, me tagrat e organit kompetent dhe përgjegjës për certifikimin e punonjësve të shërbimit të shoqërive shpsf, sqaron në kthimin e përgjigjes drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik, se afati i vlefshmërisë së certifikatave të punonjësve të shërbimit shpsf, është 4 vjeçar, nga momenti i certifikimit.

APP dhe KPP rekomandojnë se, në rastet kur në dokumentat e tenderit do të kërkohet paraqitja e certifikatave të punonjësve të të shërbimit, së bashku me këtë kriter, të kërkohet edhe paraqitja e një vërtetimi të lëshuar nga Drejtoria e Policisë Vendore, i cili duhet të përmbajë të dhëna për listën emërore të punonjësve të shërbimit të certifikuar, dhe vlefshmërinë e këtyre certifikatave, datën e certifikimit (datën e lëshimit), si dhe afatin e vlefshmërisë së kësaj certifikate.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në shkresën nr. 440 Prot., datë 17.01.2018, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Fier, ku vërtetohet performanca e veprimtarisë së SHPSF “Nazeri 2000” sh.p.k., Drejtoria Vendore e Policisë Fier nuk ka përcaktuar afat vlefshmërie të certifikatave të punonjësve të shërbimit të listuar në këtë shkresë (vërtetim), por thjesht ka cituar në listën emërore të punonjësve “*e vlefshme*” si dhe ka pasqyruar vetëm datën e marrjes së këtyre certifikatave.

Nga ana tjetër, Drejtoritë Vendore të Policive, siç cituam edhe më sipër, sqarojnë më së miri në lidhje me afatin e vlefshmërisë së këtyre certifikatave në korrespondencën zyrtare me Komisionin e Prokurimit Publik.

Komisioni gjykon se me anë të vërtetimit të kërkuar, autoritetet kontraktore kërkojnë të vërtetojnë nëse punonjësi i shërbimit është pjesë e stafit të operatorit ekonomik pjesëmarrës, si dhe datën e përfundimit të vlefshmërisë së certifikatës, ndërsa afati i vlefshmërisë së tyre përcaktohet në mënyrë eksplicite në ligj, fakt ky i theksuar edhe nga vetë Drejtoritë Vendore të Policive përkatëse, në kthimin e përgjigjes drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Myrto Security” shpk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e

rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Myrto Security” shpk, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr.REF-41282-01-22-2018 me objekt: *“Sherbimi i ruajtjes dhe siguris fizike me roje private per sh.a Ujesjelles Kanalizime Lushnje per vitin 2018- Marreveshje Kuader - me nje operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj”*, me fond limit 16, 100, 715.6 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 16.02.2018 nga autoriteti kontraktor, Ujësjiellës Kanalizime Lushnjë.
2. Të mos pranojë ankesat e operatorëve ekonomikë “Bare” shpk dhe “Nazeri” 2000 shpk për procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Myrto Security” shpk duke e kualifikuar atë.
4. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Goga” shpk duke e skualifikuar këtë operator.
5. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
6. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Myrto Security” shpk.
7. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 452 Protokoli; Datë 09.03.2018

Nr.476 Protokoli; Datë 12.03.2018

Nr. 485 Protokoli; Datë 13.03.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha